



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

VENDIM

Nr. 9, datë 11.6.2019

**PËR CAKTIMIN E DATËS PËR ZHVILLIMIN
E MOCIONIT ME DEBAT NË SEANCË PLENARE**

Në mbështetje të neneve 12, dhe 98 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KONFERENCA E KRYETARËVE

VENDOSI:

I. Më datë 13 qershor 2019, ora 10.00 do të mbledhet Kuvendi në seancë plenare për të zhvilluar mocionin me debat “Mbi aktin e Presidentit të Republikës për shfuqizimin e dekretit nr. 10928, datë 5.11.2018 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”.

II. Koha e debatit të jetë 5 orë (300 minuta), nga të cilat 170 minuta kohë për shumicën parlamentare (grupin Parlamentar të Partisë Socialiste dhe deputetët e partive që mbështesin shumicën) dhe 130 minuta kohë për pakicën parlamentare (50 minuta respektivisht për Grupin Parlamentar Demokrat dhe Grupin Parlamentar I Pavarur si dhe 30 minuta për deputetët jashtë grupeve parlamentare).

III. Rendi i ditës i planifikuar në kalendarin 3 javor për datën 13 qershor 2019 të shtyhet për datën 17 qershor 2019.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Gramoz RUÇI

